



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

02. 31/03/2016
Pr. 604 Prot

Nr.234/1.Prot

Shkodër me, 25.03.2016

Lënda: Lidhur me vendimin Nr.3 datë 9.03.2016 të këshillit të Bashkise Malesi e Madhe.

Drejtuar: Këshillit të Bashkise Malesi e Madhe.

Prefekti i qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin", neni 14, paragrafi 2, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjes vendore", neni 35, neni 54, germa f, 55/3, ligjit nr.9632 dt.30.10.2006 "Per sistemin e taksave vemndore", i ndryshuar, ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne RSH", i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", LIGJIT NR.93/2015 "Per turizmin", ligjit nr.10304 dt.15.07.2010 "Per sektorin mineral ne RSH", i ndryshuar, ligjit nr.147/2015 date 17.12.2015 "Per buxhetin e vitit 2016", Udhezimi Plotesues i MF nr.1 date 15.01.2016 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2016", udhezimi nr. 2 date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", ligjit nr.5/2016 "Per shpalljen e moratoriumit ne RSH", LIGJIT NR.8308 DT.18.03.1998 "Per transportin rrugor" i ndryshuar, VKM Nr.970 dt.2.12.2015 "Per percaktimin e procedurave dhe nte kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj", VKM Nr.783 dt.10.11.2011 "Per procedurat e ndarjes se te ardhurave te taksas vjetore te mjejeve te perdorura me njesite e qeverisjes vendore", VKM Nr.992 dt.9.12.2015 "Per disa ndryshime ne vendimin nr.54 dt.5.02.2014 te keshillit te ministrave "Per percaktimin e kriterave,procedures dhe menyres se dhenies me qera, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetore",

Analizoi vendimin nr.3 datë 20.02.2016 të këshillit të Bashkise Malesi e Madhe: "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave 2016 për territorin e njesise administrative Malësi e Madhe".

Lidhur me taksat.

- Të keni parasysh sipas nenit 22 te ligjit nr.9632 dt.30.10.2006 "Per sistemin e taksave vemndore", i ndryshuar(neni 5 i ligjit 181/2013), për shtëpitë e tjera, taksa e ndertesës duhet te jete sa 2-fishi i taksas se ndertesës qe zbatohet ne zonen ku ndodhet kjo ndertese.
- Te perjashtimet tek taksa e ndertesës te keni ne vemendje te gjitha perjashtimet nga kjo taksë (parashikuar neni 22 i ligjit nr.9632 dt.30.10.2006 "Per sistemin e taksave vemndore", i ndryshuar).

Lidhur me tarifat.

- Ligji nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3.b citon se NJQV vendos tarifa dhe taksa vendore per sherbimet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ju rekomandojmë tek tarifa e hapsires publike per qellime biznesi te beni nenkategorizime tek pika 2 e tabelës duke perfshire edhe njesi te tjera pervec lokaleve.

- Tek B.1 tarifat e shërbimit për subjektet e biznesit (fq.12), ku keni përfshirë (pastrim, gjelberim, ndricim) paragrafi i parë i shënimit në fund të tabelës nuk është i qartë. (të rishihet)
 Paragrafi i dytë: Ka mosperputhje sepse nuk është përcaktuar tarifa për njësi, pra leke për m², apo leke në vit. (të rishihet).
- Tek tarifa e shërbimit veterinar (fq.14) zbatoni ligjin nr.10465 dt.29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i cili është në fuqi.
- Lidhur me tarifat që aplikohen nga drejtoria e shërbimeve B.7 (fq.16), duhet të mbani në vëmendje ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr.8308 dt.18.03.1998 "Për transportin rrugor", i ndryshuar, që janë botuar në fletoren zyrtare të datës 7 Mars 2016.
- Tek B.10 Tarifa për shfrytëzimin e pyjeve.
 Lidhur me tarifa për shfrytëzimin e pyjeve, në zbatim të ligjit nr.5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në Republikën e Shqipërisë", do të dalin akte nenligjore.
 B.10 Gjohat, kundravajtjet administrative). (fq.19)
 T'i referoheni nenit 114 të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore", të ndryshuar me ligjin 164/2014.
- Për nivelin e gjohave për demtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të keni në vëmendje, ligjin 10463 dt.22.09.2011 "Për menexhimin e integruar të mbetjeve", neni 61, 62.
- Nivelin e gjohave për ndotje të ambientit/hapsirës publike, t'i referoheni ligjit 10463 dt.22.09.2011 "Për menexhimin e integruar të mbetjeve", VKM Nr.1096 dt.28.12.2015 Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapsirës publike, neni 4, 12 dhe 14.
- Lidhur me nivelin e gjohave në kryerjen e aktivitetit pa licence, autorizim apo leje përkatëse, t'i referoheni ligjit nr.8308 dt.18.03.1998 "Për transportin rrugor", i ndryshuar, VKM Nr.1096 dt.28.12.2015, "Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapsirës publike", neni 4, 12, 14.
- Lidhur me nivelin e gjohave për demtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndricimit rrugor, ligji nr.10279 dt.20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", neni 6, 10.
 Të jeni me të kujdesshem në përcaktimin e bazës ligjore dhe të abdetoheni me të gjitha ndryshimet ligjore.
 Prefekti ju autorizon të procedoni me rekomandimet e mësipërme.
 Me respekt,

P R E F E K T I

Paulin RADOVANI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 442 prot.

Koplik më 03/07/2016

LENDË: Dergohet Projekt-Paketa Fiskale vitit 2016.

DREJTUAR: KESHILLIT BASHKIAK

MALESI MADHE

Dergohet projekt – paketa fiskale vitit 2016 Keshillit të Bashkise në mënyrë që të shqyrtoni dhe të diskutoni të gjithë problematiken në lidhje me miratimin e saj.

Bashkangjitur po ju dergojme Projekt-Paketen Fiskale viti 2016 për Bashkinë Malesi e Madhe dhe Relacionin përkatës.

TONIN MARINAJ

KRYETAR BASHKIE





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KESHILLI

Elona Biba
16/03/16

Nr. 520.prot

Koplik më: 15/03/2016

Lenda. Dergim Vendimesh te Keshillit te Bashkise Malesi e Madhe

PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER


Bashkangjitur po ju dergojme Vendimin nr 3 date 09.03.2016 te Keshillit te Bashkise Malesi e Madhe.

Numri i fleteve te Vendimit eshte 24 (njetzet e kater)

Sekretari

Emirjan Hasmujaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
ZYRA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PAKETA FISKALE 2016

BASHKIA . MALËSI E MADHE

Relacion shpjegues

Në lidhje me projekt-vendimin për paketën fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe

Të nderuar këshilltarë !

Më lejoni të paraqes para Jush argumentat që na kanë çuar në përgatitjen e projekt-vendimit për paketën fiskale të Bashkisë sonë të dalë pas zgjedhje të 21 qershorit nga periudha 01/01/2016 deri me dt 31/12/2016

Projekt-vendimi paraqet propozimin për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për periudhën nga dt 01/01/2016 deri me dt 31/12/2016

Konteksti i ri i Bashkisë Malësi e Madhe paraqet jo vetëm zgjerim të kufijve administrativ por edhe shumëllojshmëri të territorit. Bashkia tani mbulon tashmë terriore që shtrihen nga Alpet dhe perfundojnë në vijën liqenore duke përfshirë sisteme të ndryshme terrenesh. Secili prej këtyre teritorësh ka nderthurjen e vet të traditave burimeve ekonomike burimeve natyrore e cilësive infrastrukturore Bashkia Malësi e Madhe përbehet nga 6 njësi administrative

- 1- Njesia administrative Koplik
- 2- Njesia administrative Kelmend
- 3- Njesia administrative Kastrat
- 4- Njesia administrative Shkrel
- 5- Njesia administrative K/Qender
- 6- Njesia administrative Gruemire

Ndaj ceshtja kryesore është gjetja e mundësive që të kthejmë këto burime në avantazh konkurrues dhe çdo territor të kontribuojë në mirqenien e banorve të kësaj Bashkie.

Për hartimin e kësaj Pakete Fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistet në Bashkinë Malësi Madhe

- Zyra e Taksave, Tarifave vendore
- Zyra Juridike
- -Zyra e Sherbimeve Publike dhe Infrastruktues
- Zyra e Finances
- Zyra e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit
- Zyra e Kadastrës
- Zyra e Burimeve Njerzore
- Administratoret e Njesive Vendore

Bazat per hartimin e kesaj Pakete kane qene :

1. Paketat eksistuese te Njesive Administrative.
2. Te gjithë kuadri ligjor eksistues deri me dt 31/12/2015 te gjithë nryshimet e bera ketyre ligjeve deri me dt 31/12/2015.
3. Sygjerimet e bera nga grupet e interesit dhe shoqata te ndryshme.

Qytetaret e Bashkise sone si dhe bizneset qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne territorin e Bashkise jane njohur qe 3 muaj per hartimin e kesaje pakete fiskale.

Prioritetet e kesaje pakete jane nivele minimale taksash per bizneset dhe familjet.

Tarifa te ulta dhe te referuara drejt kosos se sherbimit, shperndarje te drejte te barres fiskale, fatura te thjeshta dhe te kuptueshme transparence si dhe sherbim cilsor.


Besoj se duke dhene sygjerimet dhe mendimet qe do dalin nepermjet debateve dhe diskutimeve tuaja si dhe sqarimeve nga specialistet tane paketa do realizoje qellimin e saj.

Duke Ju ftuar që të votoni projekt-vendimin e paraqitur

Ju falenderoj për bashkëpunimin Tuaj

KRYETAR I BASHKISË MALËSI E MADHE

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
ZYRA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Vendim
Nr.3 dt.9.03.2016

Keshill bashkiak ne mbledhjen e tij te dates 9 Mars 2016 ,pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga zyra e Taksave dhe tarifave vendore"Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2016",ne zbatim te ligjit Nr.139/2015 'Per veteqeverisjen vendore",neni 9, pika 1.3 germa b, neni 54, germa f, neni 55/3, ligjit nr.9632 dt.30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne RSH", i ndryshuar,ligjit nr.107/2014 'Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Ligji Nr. 9385 datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar ,VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave, dhe te kushteve per dhenien e Licensave per tregtimin e naftes bruto dhe te nenprodukteve te saj".me propozim te kryetarit te Bashkise vendosi:

Vendosi

- Të miratojë paketën fiskale të vitit 2016 për Bashkinë Malësi e Madhe 2016.
- Ky vendim u shpall me dt. 09/03/.2016.
- Hyn në fuqi sipas nenit 55/ 6 te ligjit nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore".

Per keshillin e bashkise Malesi e Madhe
Sekretari /Keshillit Kryetari
Emirjan Hasmuja Ilir HaLAJ



B. TAKSAT VENDORE

B.1. TATIMI I THJESHTRUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Shkalla tatimore

Ne zbatim te ligjit Nr. 142 date 17.12.2015.(neni 5,6)

1.Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është **5 për qind**.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është **0 (zero) lekë /vit**.

- * Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

Administrata tatimore qendrore për shërbimin që kryen merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arketuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili mban 1% dhe derdhet në llogari të administratës Tatimore Qendrore.

B.2. TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme përbëhet nga:

- *Taksa mbi ndërtesat
- *Taksa mbi tokën bujqësore.
- *Taksa mbi truallin.

Ne zbatim te nenit 22 te ligjit nr. Ligji nr. 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" te ndryshuar,

- Taksa mbi ndërtesën

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas

dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa.". Kategoritë minimale të ndërtesave, për efekt

të bazës së taksueshme, jepen në aneksin 1, që i bashkëlidhet ligjit nr.142/2015. Për çdo kategori minimale të ndërtesave, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nënkategorizime të ndërtesave, që ndodhen brenda territorit që mbulon.

B.2.1. TAKSA MBI NDERTESAT

<u>Kategoritë e ndërtesave</u>	<u>Njesia e matjes</u>	<u>2016</u>
◦ <u>2.1. NDERTESA BANIMI</u>		
◦ Ndertesa banimi te ndertuara para vitit 1993.(Nj.A. - Koplik Qyteti).	leke/m2/ vit	5
◦ Ndertesa te ndertuara gjate dhe pas vitit 1993. (Nj.A - Koplik. Qyteti)	lekë/m2/vit	6
◦ <u>Njësia administrative</u> Kelmend,Kastrat Shkrel, Gruemire, Qender.(para v.1993)		2.5
◦ Njësia administrative (Qender ,Kelmend,Kastrat Shkrel, Gruemire).	lekë/m2/vit	3
<u>I. NDERTESA TE TJERA</u>		
◦ <u>2.2. Ndertesa të tjera për tregti dhe Sherbime.</u>		
a.) (Njësia administrative Koplik, Qyteti)	lekë/m2/vit	200
b) Nj.A. Kelmend,Shkrel,Kastrat,Gruemire Qender.	lekë/m2/vit	100
<u>2.3 TE TJERA.</u>		
a.)Bashkia Koplik (Nj.A - Koplik).		40
b.)Njësia administrative Kelmend, Kastrat, Shkrel,Gruemire,Koplik Qender.	lekë/m2/vit	20



2.4 Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese.		
a.) Bashkia Koplik (Nj.A - Koplik).	lekë/m2/vit	100
b.) Njësia administrative Kelmend, Kastrat Shkrel, Gruemire, Koplik Qender.	lekë/m2/vit	50
2.5 Ndërtesa në pronësi po në përdorim në	lekë/m2/vit	400
territore të miratuara si fshatra turistik.	lekë/m2/vit	200
o <u>Per njesite administrative</u>		

- I. Ne te gjitha njesite administrative te tjera, niveli tregues i takses per cdo kategori minimale te nderteses eshte sa nje e dyta e nivelit tregues te kategorise minimale ne nj.a. te percaktuara ne tabele.
- II. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa-shitura taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës.
Ambientet e hipotekuara si:
-apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategoritë, " ndërtesa banimi"
- ndërtesat e biznesit do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategoritë " ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime".
- III. Mardheniet kontraktuale rregullohen sipas ligjeve ne fuqi

Ligji Nr.9632 , dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me ligjin 142 date 17.12.2015.(neni 22)).Sipas aneksit nr. 1 "Nivelet e takses nderteses."

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si dokumentacion një nga dokumentat e mëposhtme:

- o Vërtetimin e pronësisë
 - o Vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave
 - o Vendimet e privatizimit
 - o Vendimet e komisionit të verifikimit të pasurive të paluajtshme
 - o Vetdeklarimin
- Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Përfshihen nga taksa e ndërtesës :

- o për familjet invalidë (kryefamiljare) pa persona madhore

- veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar(kryefamiljare)
- invalidët e punës(kryefamiljare) pa persona madhore
- të verbërit(kryefamiljare) pa persona madhore
- invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë(kryefamiljare) pa persona madhore
- Te gjithë kjo kategori e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, date 17.11.1994 "Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër pushtuesit nazifashistë të popullit shqiptar", ligjit nr 8098 datë 08.03.1996 "Për statusin e të verbrit dhe ligjit nr 7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".
- Familjet qe kane grate kryefamiljare (me te ardhura nen minimumim jetik).

- *Struktura e ngarkuar* për vjeljen e Taksës mbi Ndërtesat për subjektet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malesi e Madhe

B.2.2. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

	KATEGORIA E TOKËS	Njësia	2016
1	Kategoria I,II,III	Lekë/ha/vit	0
4	Kategoria IV	Lekë/ha/vit	1000
5	Kategoria V	Lekë/ha/vit	900
6	Kategoria VI	Lekë/ha/vit	800
7	Kategoria VII -X	Lekë/ha/vit	700

Perjashtohen nga Taksa mbi tokën bujqësore sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vjetët e para nga çasti i mbjelljes.

Neni 11 i ligjit 142/2015 citon "Ne rast te mungeses te dokumentacionit te proneses, perdoruesi i tokes bujqesore ben nje vetedeklarim te sipërfaqes te tokes bujqesore , prane Bashkise ku ndodhet toka".

B.2.3. TAKSA MBI TRUALLIN (JO HAPESIRE PUBLIKE).

Neni 2 i ligjit 142/2015 : Me "truall", nënkuptojmë një sipërfaqe toke, jo bujqësore që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Neni 23 i ligjit Nr.9632 , dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. **Detyrimi i taksës** llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. **Nivelet treguese** të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2.1, të ligjit.Nr.142/2015.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim pranë Bashkisë ku ndodhet trualli.

	Taksë trualli	Njesia matjes	2016
1	Truall për qëllime banimi nga individët.	Lekë/m ² /vit	0.14
2	Truall për qëllime biznesi.	Lekë/m ² /vit	12

B.3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Ne zbatim te nenit 13 te ligjit nr.142/2015 theksojme:

- . **Baza** e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve te qendruara ne hotel
- . **Niveli** tregues i taksës është sipas aneksit 8 bashkëlidhur këtij ligji.

2	<u>Hotelet nën 3 yje - bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizëm.</u>		
	a.) Bashkia Koplik (Nj.A - Koplik).	Lekë/natë/fjetje	35
	b.) Njësia administrative Kelmend, Kastrat Shkrel, Gruemire, Koplik Qender.	Lekë/natë/fjetje	35

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malesi e Mde.

Derdhja e të ardhurave për këto takse nga hoteli në favor të bashkisë nën juridiksionin e të cilit ndodhet vendodhja e tij.

B.4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Taksa e ndikimit në Infrastruktura.

Neni 14 I ligjit 142/2015 thuhet:

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga **shoqëritë e ndërtimit**, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën **4 për qind deri 8 për qind** të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është **1 deri në 3 për qind** e kësaj vlere.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është **0,1 për qind** e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është **0,5 për qind** e vlerës së investimit.

4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të takses.

Nr.	Emertimi	Niveli
a-	Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga <u>shoqëritë e ndërtimit</u> të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.	4 %
b-	Strukture banimi	2 %
c-	Strukture me funksion biznesi të çfaredo lloji (tregti shërbime, prodhimi etj)	3 %
d-	Infrastruktura si: rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni.	2 %

Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.

Në rastin e më shumë se një objekti të legalizuar, janë këto përcaktime:

Nr.	Emertimi	Niveli
a-	Strukture banimi	2 %
b-	Strukture me funksion biznesi të çfaredo lloji (tregti shërbime, prodhimi etj)	3 %

Nëse objekti për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe ndikimit të investimit në infrastrukturën e së cilës bashki.

Në rastin kur investitor është Bashkia M. Madhe, kjo takse nuk aplikohet.

Strukture e ngarkuar është drejtorja e të ardhurave. (zyra taksave tarifave vendore)

B.5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PASURITË E PALUAJTSHME,

Ligji Nr.9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (neni 28)

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së rregjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Baza e takses për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzimi i nivelit të takses me bazën e tij. Baza e takses për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të

paluajtshme eshte vlera e shitjes se tyre .Niveli i takses caktohet ne perqindje dhe niveli tregues i tkses eshte 2%.Detyrimi tatimor llogaritet si shumezim i nivelit te takses me me bazen e tij.Vjelja e kesaj takse behet nga zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshm,e, te cilat ne rolin e agjenit perfitojne 3% te shujmes se arketuar dhe diferencen e derdhin per llogari te buxhetit te bashkjise , ne territorin e se ciles ndodhet pasuria.

	<u>Kategoria</u>	Njësia e matjes	2016
1	Ndërtesa banimi	lekë/m2	100
2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime	lekë/m2	300
3	Ndërtesa të tjera	lekë/m2	200

Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.
- personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë: i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
- bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.Ne rastet kur pranohet nga vete palet ose kur vërtetohet ligjerisht simulimi i dhurimit per llogari ten je shitjeje , per shmngie nga taksa , zbtohen taksa se dy-fishi I vleres , pamvaresisht nga pergjegjesite e tjera sipas ligjeve ne fuqi.

6. TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet taksapaguese.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve, shërbimit të transportit të mallrave ose subjekte të tjera të shërbimit të cilat nuk kanë mundësi praktikë për vendosjen e saj.

<u>Taksë table</u>	Njesia matjes	Niveli i takses
<u>Kategorite:</u>		



		2016
1. Tabelë për qëllime identifikimi <i>deri në 2 m²</i> të trupëzuara në sip. ndërtesë ose brënda territorit ku zhvillohet aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin të tregut. Në të tilla tabela vendoset emri/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	leke/vit	0
a. Tabela për qëllime identifikimi <i>mbi 2 metra</i> katror të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës së ndërtesës ose Brenda territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin të tregut, ku vendoset emri dhe ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	leke/m ²	45000
b. Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e permasat e tabelave të sinjalistikës për orientim	leke/vit	120
2. Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme si dhe e palëvizshme.		
Tabelë e thjeshtë.	lekë/m ² /vit	13500leke/m ² /vit
Tabelë elektronike.	lekë/m ² /vit	27000leke/m ² /vit
3. Tabelë në funksion të ekspozimeve të hapura (panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj).	lekë/m ² /ditë	1000

Detyrimi për Taksën e tabelës për kategorinë 1 dhe 2, është vjetor. Afati i pagesës është brenda vitit kalendarik.

Struktura e vlerës është Drejtoria e të ardhurave pranë Bashkisë M. Madhe e cila bashkëpunon me Drejtorinë e planifikimit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit.

8. TAKSA VJETORE MJETEVE TË PËRDORURA.

V.K.M. Nr.783 datë 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të takses vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë qeverisjes vendore" i ndryshuar me V.K.M Nr.923 datë 29.12.2014.

1. Drejtoria Rajonale e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor, së bashku me drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor në varesi të saj, të caktuara me ligj si agjent tatimor të mbledhjes të takses vjetore të mjeteve të përdorura, deklarojnë dhe paguajnë taksën

brena dates 15 te muajit pasardhes, per llogari te organeve tatimore te administrates qendrore dhe njesive te qeverisjes vendore, sipas percaktimeve ne udheziin e Ministrise se Financave..

2. Nga shuma e pergjithshme te te ardhurave mujore te arketura nga taksa vjetore te mjeteve te perdorura, Drejtorire Rajonale te DRSHTRR-se ,bajne komisionin pre 5% te totalit mujor te te ardhurave , derdhn me anete fatures per arketim 18% te ketyre te ardhurave ne llogarine bankare te deges se Thesari , te bashkise M.Madhe dhe 82% te te ardhurave derdh per llogari te drejtorise rajonalr , ku eshte regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve te medhenj).

B.9 .GARANCI FINANCIARE PER SUBJEKTET FIZIKE/JURIDIKE,KERKUES I LEJES PER NDERTIMIN, RIPARIMIN, RESTAURIMIN APO SHEMBJEN E OBJEKTIT.

Garancia financiare: Ne mbeshtetje te pikes 10 te VKM. Nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekti fizik/juridik, kerkues i lejes per ndertimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, perpara marrjes se lejes se ndertimit duhet te depozitoje nje garanci per llogari NJQV-se, e cila nuk do te jete me vogel se 3% e vleres se struktures se objektit dhe percaktohet me vendim te keshillit te NJQV. Njesite e qeverisjes vendore, me konkretisht Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit te Territorit, ne dokumentacionin e dhenies se lejes per projektin e ndertimit ,riparimit, restaurimit apo shembjes se objektit, percaktojne se personi juridik apo fizik ,te cilit I eshte dhene leja per realizimin e projektit duhet te provoje me dokumentacionin e nevojshem permbushjen e kerkesave sipas VKM nr. 575 date 24.6.2015 brenda 30 diteve nga data e perfundimit te projektit te ndertimit, riparimit apo restaurimit te objektit ,i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit juridik/fizik pa interes nga Bashkia, e cila ka leshuar lejen e ndertimit, pasi te provoje se mbetjet jane dorezuar sipas pikave 4,5 dhe 6 te VKM NR.575 dt.24.6.2015 ne venddepopzitimn e perkohshem(apo landfilldin) te percaktuar nga Bashkia. Ne rast te kundert, te mospermbushjes se kushteve te lartpermendura bashkia konfiskon garancine financiare.

Strukturat pergjegjese per vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar per llogaritjen e pageses se garancise financiare eshte konkretisht Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit te Territorit.

Struktura e ngarkuar per vjeljen e detyrimit eshte Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore prane Bashkise.

TARIFAT 2016

1. "Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike për Qëllime Biznesi"

Neni 16 i ligjit nr.142/2015: ku thuhet " c) paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendres së banuar.

Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor."

Tarifa te perkohshme		2016
1. Zënia e hapësirës publike për zhvillimin e aktiviteteve tregtare dhe bizneseve të shërbimit për sezonin turistik.	Lekë /m2/dite	60
2. Zënia e hapësirës publike nga lokalet .	Lekë/ m2/dite	60
3. Zënie të hapësirës publike (ditore) për qëllime biznesi ekspozim/reklamimi promocion I produkteve aktiviteteve tregare.	Lekë/ m2/dite	1000

Sipërfaqia që do të përdoret dhe koha e përdorimit të saj do të përcaktohet me autorizim nga Drejtoria e Shërbimeve.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses: ngarkohet Zyra Taksave dhe Tarifave Vendore prane Bashkise.

- V.K.M. Nr.1096 date 28.12.2015 "Per miratimin e rregullave,kushteve ,procedurave per perdorimin e menaxhimin hapësirave publike".

B.1 TARIFA E SHERBIMIT ADMINISTRATIV TE BASHKISE MALËSI MADHE.

B.1.1 TARIFA E SHERBIMEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET E BIZNESIT (PASTRIM, NDRICIM, LARGIM MBETURINASH) 2016.

- Nisur nga kostoja që bëhet për pastrim-gjellbërim dhe ndricimin për familje për bizneset e medha dhe te vogla, kazarët e pasrimit për mirembajtjen, zevëndesimin e tyre, grumbullimin dhe përpunimin e tyre tarifën parashikohen si më poshtë:

	Kategoria për bizneset e vogla per bashkine dhe njesite administrative.	Lekë/vit/njesi	2016
1	Subjekte të biznesit te vogel deri ne 5 milion lek	lekë/vit/njesi	4000
2	Subjekte të biznesit te vogel (me tvsh) 5-8 milion lek • Nga keto:	lekë/vit/njesi	8000
3	a. Markete dhe supermarkete	lekë/vit/njesi	20000
4	b. Restorante	lekë/vit/njesi	15000
5	c. Lende ndertimi, punime duralumini	lekë/vit/njesi	15000
6	d. Subjekte hotelerie (bujtina, motele, fjetina etj)	lekë/vit/njesi	15000
7	Subjekte ambulant (te tregjet)	lekë/vit/njesi	4000

Tarifa e shërbimeve publike është vjetore dhe do të llogaritet për cdo muaj të punuar, përjashtohen nga ky rregull subjektet hoteliere, detyrimi i tyre do të jetë sipas vlerës në tabelën e mësipërme.

Në rastet kur subjekti hotelier ka edhe bar apo restorant detyrimi për to do të llogaritet në varësi të sipërfaqes me nivelin e subjekteve të tregtisë me pakicë. Afati i pagesës do të jetë brenda njoftimit të bere.

B.1.2.TARIFA E SHERBIMEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH

	Kategoria	lekë/vit	2016
1.	Shoqëritë e ndërtimit.(subjekte ndërtimi)	lekë/vit	70000
2.	Shoqëritë tregëtare,prodhuese,shërbimi.	lekë/vit	50000
3.	Shoqëritë anonime dhe filiale të kasinove	lekë/vit	100000
4.	Filiale të tjera të SH.A. - ve	lekë/vit	60000
5.	Institucionet Shtetërore	lekë/vit	50000
6.	Karriera dhe inerte	leke/vit	150000
7.	Karburante	leke/vit	100000
8.	Bankat e nivelit të dytë.	leke/vit	80000
9.	Profesione të lira	leke/vit	8000
10.	Subjekte përpunim-tregtim lende drusore,bime medicinale.	leke/vit	100000

- Subjektet e biznesit të madh që operojnë në territorin në juridiksion të Bashkisë Malesi e Madhe por që selinë e tyre e kanë jashtë këtij territori, do të paguajnë të njëjtin nivel tarife me subjektet që e kanë selinë në territorin e Bashkisë. Detyrimi për tarifën do të llogaritet për kohën e kryerjes së aktivitetit. Afati i pagesës do të jetë brenda vitit 2016.
- Subjektet që do të paguajnë detyrimet fiskale brenda afatit të njohimit do të përfitojnë zbritje 10% nga shuma totale e detyrimit.

B. 1.3 TARIFA SHERBIMI PËR FAMILJARET.

Ne këto tarife shërbimi pakete(pastrim,ndricim,gjelberim) janë të përfshira këto shërbime:

(Pastrimi,fshirje rruge e trotuari,largimi mbeturinave,ndricimi publik,dekorim festash).

•	Nj.Administrative	Koplik (qyteti)	3000	per familje	leke ne vit.
•	"	Kastrat	1500	" "	leke ne vit.
•	"	Shkrel	1500	" "	leke ne vit.
•	"	Qender	1500	" "	leke ne vit.
•	"	Gruemire	1000	" "	leke ne vit.
•	"	Kelmend	1000	" "	leke ne vit.

Përfshihen nga tarifa e mesiperme:

- invalidët(kryefamiljare) pa persona madhore
- veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar,
- invalidët e punës, (kryefamiljare) pa persona madhore
- të verbrit(kryefamiljare) pa persona madhore
- invalidët paraplegjik e tetraplegjikë. (kryefamiljare) pa persona madhore
- familjet qe kane grate kryefamiljareme 2 femije ne ngarkim (nen 21 vjec)
- Sa me lart fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr 7874 datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesit nazifashist të popullit shqiptar" i ndryshuar, ligjit nr 8098 datë 28.03.1996 " Për statusin e të verbrit" dhe ligjit nr 7889 datë 14.12.1994 'Për statusin e invalidit'.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës së shërbimit ,për subjektet, është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malesi e Madhe.

B.2. TARIFA PER LEJE DHE SHERBIM VETERINAR

B.2.1	Tarife per vulosje veterinare te bagetive te therura ne vende therje te aprovuara.	Njesia matjes	2016
	• per bageti te trasha	Lekë / koke e therur	100
	• per bageti te imta	Lekë / koke e therur	50

Veterineret percjellin informacionin ne drejtorine e taksave e tarifave vendore

Tarifat mbulohen nga subjekti qe kryen sherbimin.

Struktura e ngarkuar per vjeljen e tarifes se sherbimeve ,Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Ligji nr. 9308 date 04.11.2004 "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin Veterinar", i ndryshuar.

B.5 TARIFA E PARKIMIT TE AUTOMJETEVE TE LICENSUARA.

Në zbatim të ligjit nr.8378 date 22.07.1998 "Kodi Rrugor ne Republiken e Shqiperise"

	Tarife shërbimi për parkimin e automjeteve	Njesia matjes	2016
1	Autovetura dhe taksi(4+1)	Lekë/vit/mjet	2500
2	Furgone dhe Mikrobuze		
	a) Transport pasagjeresh	Lekë/vit/mjet	3000
	b) Transport mallrash	Lekë/vit	3500
3	Autobuz vendparkim i miratuar	Lekë/orë/mjet	50
4	Automjet transport malli deri 3.5 ton	Lekë/vit/mjet	1500
5	Automjet transport malli mbi 3.5 ton-8 ton	Lekë/vit/mjet	2000
6	Automjet transport malli mbi 8 ton-14 ton	Lekë/vit/mjet	3000
7	Automjet transport malli mbi 14 ton	Lekë/vit/mjet	4000
8	<u>Per parkim të rezervuar</u>	Lekë/vit	
a.	Per Autobusa	Lekë/vit	35000
b.	Per furgona transport mallra me biznes afer rruges.	Lekë/vit	15000
c.	Per autoveture(taksi) 4+1 dhe 8+1 <u>te licensuara</u> .	Lekë/vit	20000
9	Tarifë parkimi(parkim me pagesë)(1 tetor-31mars)	Lekë/orë	50
10.	Tarifë parkimi(parkim me pagesë)(15 korrik - 31shtator)	Lekë/orë	100

Struktura e ngarkuar për administrimin e tarifës së parkimit të automjeteve është Drejtoria e Shërbimeve.

B.7 TARIFAT QE APLIKOHEN NGA DREJTORIA E SHERBIMEVE

- Licensat/Certifikatat dhe Autorizimet qe leshohen ne fushen e transportit sipas Ligjit nr. 8308 "Per Transportet Rrugore" i ndryshuar.
- Udhezimit nr. 15 date 24.07.2007 "Per kriteret dhe procedurat e leshimit te Licensave, Autorizimeve dhe Certifikatave ne ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor", i ndryshuar me udhezimin 421 date 22.01.2016.

	Sherbimi qe kryhet	Njësia	2016 Afat 5 vjet
1	License per trans -udhetare ne linje te Rregullt Rrethqytetase.	Leke/linje	20000
2	Çertifikate trans.udhetaresh ne linje rregullt Rrethqytetse.	Leke/mjet	7500
3	License trans.udhetar.linje te rregullt nderqytetase brenda qarkut.	Lekë/linje	75000
4	Çerfitikate trans.udhetar. linje te rregullt nderqytetase e brenda qarkut.	Lekë/mjet	7500
5	License trans udhetare linje nderqytetse ndermjet qarqeve	Lekë/linje	75000
6	Certifikate trans udhetare linje nderqytetse ndermjet qarqeve,	Lekë/mjet	7500
7	License transport udhetaresh - taksi	Lekë/mjet	20000
8	License agjensi trans.udhetar.me taksi brenda vendit	Per licence	15000
9	<u>Transport mallrash brenda vendit</u>		
10	Autorizime te ndryshme te perkohshme nje mujor (veprimtari te tjera)	Per /autorim	2000
11	License trans.mall.per te trete dhe qera brenda vendit	Lekë/license	40000
12	Çerfitikate trans.mall.per te trete dhe qera brenda vendi	L/ton/kapac.	100
13	Çerfitikate transport malli brenda vendit per llogari te vet.	L/ton/kapac.	100
14	Çerfitikate transport malli brenda vendit per llogari te vet.	L/ton/kapac.	100

- Për dhënie dublikate me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vlerës së plotë.

- Per rastet e ndryshimeve ne license/certificate kane te bejne me element te perdoruesit te mjetit,fushes se operimit etj. paguhet 30% e vleres se plote.
- Struktua per vjeljen e ketyre tarifave eshte zyra e sherbimeve, ne bashkepunim me zyren e te ardhurave.

B.8. TARIFAT PER SHERBIMET QE KRYEN DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT.

Keto tarifa do te aplikohen ne zbatim te *ligjit nr.107/2014 'Per palnifikimin dhe zhvillimin e territorit "i ndryshuar ligji 73/2015(Neni 38,39,41,42 " Leje ndertimi", "Leje zhvillimit", "Deklarata paraprake per kryerjen punimeve", "Çertifikata perdorimit") V.k.m. Nr.408 dt.13.05.2015, V.k.m. Nr..1096 date.28.12.2015, vkm Nr.671 dt.20.07.2015 , si dhe akteve te tjera nenligjore.*

Grupi i tarifave te meposhtme aplikohet per sherbimet qe banoret/subjektet marrin nga Bashkia per çeshtje qe lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit te territorit.

Nr	LLOJET E TARIFAVE	NJESIA E MATJES	TARIFA
1.	<u>Pranim dosje per shqyrtim per leje per llojet e aplikimeve:</u>		
a-	Strukture banimi	Leke/dosje	5.000
b-	Strukture me funksion biznesi te çfaredo lloji(tregti sherbime,prodhimi etj)	Leke/dosje	7.000
c-	Infrastrukture si: rruge,ujesjelles,kanalizime,ndriçim publik,telefoni	Leke/dosje	7.000
2.	<u>Leshim çertifikate perdorimi me perdorim te specifikuar:</u>		
a-	Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga <i>shogëritë e ndërtimit</i> , të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.	Lcke/cope	10.000
b-	Strukture banimi	Leke/cope	2.000
c-	Strukture me funksion biznesi te çfaredo lloji(tregti sherbime, prodhimi etj)	Leke/cope	5.000
d-	Infrastrukture si: rruge,ujesjelles,kanalizime,ndriçim publik,telefoni.	Leke/cope	5.000
3.	<u>Tarife per dhenie dokumentash nga arkiva e DPKZHT-se.</u> TE shihet ne perputhje me udhezimin nr.1 dt.16.06.2011		
a.	Fotokopje e njesuar 1:500 v.1990-2015 A3	Leke	500
b.	Fotokopje e njesuar 1:500 v.1990-2015 A4	Leke	200
c.	Fotokopje e studimeve urbanistike ne fuqi A3	Leke	500
d.	Fotokopje e studimeve urbanistike ne fuqi A4	Leke	200

Strukture e ngarkuar per vjeljen tarifes se sherbimit eshte Zyra Taksave dhe Tarifave Vendore.

B.1.3.TARIFA PER SHERBIME TË TJERA, TE KRYERA NGA BASHKIA M.MADHE

1	Per lëshim vërtetim nga arkivi	Lekë/per dokument	500
2	Informacion për zyra avokatie	Lekë/per dokument	2000
3	Informacion tekniko-ligjor per publikun	Lekë/dokument	500
4	Per vertetime te leshuara nga Zyra e gjendjes civile	leke/dokument	100
5	Tarifa per dhenie leje ushtrim veprimtarie.	Leke/dokument	500

B.9 TARIFA PER DHENIE LICENSE PER TREGTIMIN E NAFTES BRUTO DHE TE NENPRODUKTEVE TE SAJ.

Baza ligjore: V.K.M Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe te nënprodukteve të saj "

- VKM nr.970 date 02.12.2015 percaktohet tarifa mbi leshimin e lejeve (autorizimeve) per subjektet qe ushtrojne aktivitet ne fushen e tregtimit te karburanteve ,nenprodukteve te naftes,gazit te lengshem dhe gazit.
- Shoqerite qe operojne ne aktivitetin e tregtimit me pakice te karburanteve,gazit te lengshem te naftes,per automjetet,vajrave lubrifikante dhe lende djegese per perdorim nga konsumatorët fundore,qe nuk jane te paisur me license te vlefshme,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi,brenda 6-muajve,nga hyrja ne fuqi e ketij vendimi,duhet te plotesojne kushtet,sipas percaktimeve te ketij vendimi,dhe te ndjekin procedurat per aplikim per paisjen me licensen perkatese.

1. DHENIE DHE PERSERITJE E LICENSAVE PER STACIONET E SHITJES SE. KARBURANTEVE ,GAZIT TE LENGHEM TE NAFTES, PER AUTOMJETET DHE VAJRAVE LUBRIFIKANTE 2.000.000 LEK
2. DHENIE E LICENCAVE PER NJESITE E SHITJES SE LENDEVE DJEGESE,PER VEPRIMTARINE TREGTIMIT PER PERDORIM NGA KONSUMATORE VENDORE. 200.000 LEK.

B.10 TARIFA PER SHFRYTEZIMIN E PYJEVE

- Ligji nr. 5/2016 "Per shpalljen e Moratoriumit ne pyje ne Republiken e Shqiperise"
- Tarife baze te lendes drusore ne kembe,perllojet industriale

Nr.	Lende drusore ne kembe	Njesia matjes	Tarifa
1.	Arre,geshtenje,panje,vith	m3	5.000
2	Carac,eukalipt,mane,melleze,plep,shkoze,shelg,rrap	m3	2.000
3.	Bli,frasher,geshtenje eger,meshteken,verri	m3	3.500

Kur lenda e punimit dhe drute e zjarrit jane nxjerre nga sipërfaqe te djegura,por materiali drusor eshte I perdorshem,tarifat per to do te jene 40% me te uleta se tarifat baze.

B.10 GJOBAT, KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Mbështetja ligjore : Ligji Nr.9632,dt.30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar; Ligji Nr.9920 , dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar me ligjin 164/2014 neni 22, Ligji Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 6, pika b.

1. Gjoha per mosshlyerje te detyrimeve tatimore(taksa,tarifa).

a. Gjoha për mosshlyerje të detyrimeve tatimore brenda afatit 20 Maj.	% per çdo rast.	Për cdo muaj vonesë 5 % e vlerës së detyrimit total te papaguar.(maksimumi 25%)
b. Nëse subjekti i ri ose adresa sekondare e re rregjistrohen pas datës 20 Maj, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve është 30 ditë pas datës së rregjistrimit.		

- Gjohat aplikohen vetem per subjektet e tatueshme(qe kane detyrim te paisen me NIPT).
- Afati i fundit per likuidimin e detyrimit fiskal vjetor te vitit aktual eshte data 20 Qershor e ketij viti.
- Baza e llogaritjes se gjobes per zerin IV/1 perfshin detyrimet totale te gjithë vitit aktual qe lindin nga: tarifat e pastrimit,ndricimit, taksa e tabelës per qellime identifikimi,taksa e ndertesës dhe taksa e truallit.
- Subjektet e reja si dhe adresat sekondare te celura rishtazi kane afat deri 20maj per shlyerjen e detyrimit.nese celja behet pas dates 20 Maj, afati i fundit i shlyerjes detyrimeve tatimore eshte 30 dite pas dates se regjistrimit.
- Per gjithë subjektet fizike/juridike qe nuk kane shlyer detyrimin tatimor per vitin 2015 do ta shlyejne ate se bashku me detyrimin e vitit 2016.
- Vlera e gjobes llogaritet 5% per muajin e plote kalendarik brenda se ciles skadon afati,dhe 5% per cdo muaj te plote kalendarik ne vazhdim,por ne asnje rast shuma totale e gjobes nuk duhet te jete me e madhe se 25% e detyrimit vjetor te papaguar.
- Struktura e ngarkuar per llogaritjen e mbledhjen e ketyre gjobave eshte Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore prane Bashkise.

2. Gjoha nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.

Sipas ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar dhe akteve nenligjore qe rrjedhin nga ky ligj.

3. Llojet dhe nivelet e gjobave per shkeljet e kundravajtjet administrative.

Niveli i gjobave per demtim dhe nderhyrje ne infrastrukturen rrugore.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Vlera
1.	Demtim rruge	leke	15000
2.	Bllokim rruge	leke	10000
3.	Demtim bordure	leke	8000
4.	Demtim trotuari	leke	15000
5.	Bllokim trotuari	leke	10000
6.	Demtim,bllokim,vjedhje pusete	leke	15000
7.	Ndotje te rrugeve nga mjete transporti ne qytet:		
	• Persona juridike	leke	13000
	• Persona fizike	leke	10000
	• Qytetare	leke	8000

1.2 Niveli i gjobave per ndotje te ambientit/hapesires publike.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Vlera
1.	<i>Hedhje e mbetjeve urbane ne rruge,trotuar, kudo ne hapesiren publike,jashte vendeve percaktuara</i>	leke	
	• Persona juridike	leke	15000
	• Persona fizike	leke	10000
	• Qytetare	leke	8000
2.	<i>Hedhje inerte ne vende te pamiratuara</i>		
	• Persona juridike	leke	15000
	• Persona fizike	leke	10000
	• Qytetare	leke	8000
3.	<i>Vendosje pa leje e posterave,tabelave,banderolave</i>	leke	12000

- Ligji 10440 date 07.07.2011 "Per vlersimin e ndikimit ne mjedis" i ndyshuar ligji 12/2015.

1.3 Niveli gjobave per kryerjen aktivitetit pa license,autorizim apo leje perkatese.

Ligji nr.8224 date 15.05.1997 "Per organizimin edhe funksionimin e Policise se bashkise dhe te Komunes". NENI 8.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Vlera
1.	<i>Mospaisja me license,autorizim apo certificate perkatese transporti.</i>	leke	
	• Motokarro	leke	2000
	• Transport udhetare taksi 4+1	leke	10000
	• Transport udhetare taksi 8+1	leke	15000
	• Mjete tonazhi te larte	leke	20000
	• Hyrja pa autorizim ne rruget kryesore te qytetit per mjetet e tonazhit te larte.	leke	15000
2.	<i>Shitje e lendeve djegese pa license,per perdorim nga konsumatorët fundore.</i>	leke	15000

3.	Mosapisje me leje per zenie hapesire publike.		
	• Ekspozim malli	leke	5000
	• Veprimtari te cilat do zhvillohen ne hapesirat publike.	leke	10000
	• Sherbim me tavolina jashte lokalit	leke	15000
4.	Mospaisje me leje per vendosje reklame.		
	• E thjeshte	leke	10000
	• Elektronike	leke	15000
5.	Mosmarrja masave per izolimin e ambjentit per daljen e zhurmave nga ambientet e lokaleve.	leke	15000

- V.K.M. Nr.1096 date 28.12.2015 "Per miratimin e rregullave,kushteve ,procedurave per perdorimin e menaxhimin hapesirave publike".
- Ligji 8308 date 18.03.1998 "Per transportet rrugore" te ndryshuar
- Udhhezimi nr. 15 date 24.07.2007 "Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licensave,autorizimeve dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin urban",i ndryshuar udhezimi 421 date 22.01.2016.
- V.K.M. Nr.1096 date 28.12.2015 "Per miratimin e rregullave,kushteve ,procedurave per perdorimin e menaxhimin hapesirave publike".

1.4 Niveli i gjobave per demtime dhe nderhyrje ne rrjetin e ujesjellesit.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Vlera
1.	Lidhje e pa miratuar ne tubacion	leke	15000
2.	Demtim i pusetave	leke	10000
3.	Demtim i tubacioneve nga punimet qe kryhen tyre me leje ose pa leje.	leke	15000

1.5 Niveli i gjobave per demtimet dhe nderhyrjet ne rrjetin e ndricimit rugor.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Vlera
1.	Lidhje ne rrjetin ajror te ndricimit	leke	15000
2.	Demtim te shtyllave ndricimit publik	leke	15000
3.	Perdorimi i shtyllave te ndricimit si suport per montimin e reklamave,kapjen e kabllave etj.	leke	8000
4.	Demtim i ndricuesve te ndricimit publik	leke	15000
5.	Demtim i kabllave elektrike,te internetit apo te telekomit nga punimet qe kryhen me leje ose jo.	leke	15000
6.	Nderhyrje ne kuadrot elektrik publik.	leke	10000

1.6 Niveli i gjobave per inspektoriatin veterinar.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Vlera
1.	Per mishin e therur,te tregtuar te pa certifikuar nga Inspektoriati Veterinar.	leke	10000

- Ligji nr. 9308 date 04.11.2004 "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin veterinar".

- Kjo pakete fiskale do te duhet qe te marre mbeshtetjen e duhur nga te gjithë palet, pasi ky material i pregatitur mbi gjithçka eshte mbeshtetur mbi baza qe te kete gjithperfshirjen sa me te gjere nga te gjithë faktoret dhe aktoret qe punuan per hartimin e kesaj projekt - pakete.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

PER KESHILLIN BASHKISE MALESI E MADHE

SEKRETARI

KRYETARI

/EMIRJAN HASMUJAJ/

/ ILIR HALAJ /

Has-77



[Signature]